

VENDIM
Nr. 25, datë 10.5.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e	Gjykatës Kushtetuese
Elsa Toska,	anëtare e	“ “
Fiona Papajorgji,	anëtare e	“ “
Altin Binaj,	anëtar i	“ “
Përparim Kalo,	anëtar i	“ “
Sonila Bejtja,	anëtare e	“ “
Marsida Xhaferllari,	anëtare e	“ “

me sekretare Enina Kotoni, në datat 6.4.2021 dhe 6.5.2021, mori në shqyrtim, në seancë plenare publike, çështjen nr. 1 (Z) 2019, të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Zef Hila, përfaqësuar nga avokati Jordan Daci, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Elira Kokona dhe Abaz Deda, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 445, datë 28.6.2019, “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë së Vaut të Dejes, z. Zef Hila”, si i papajtueshëm me Kushtetutën.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 13, 17, 30, 33, 42, 115, pika 2; 116, 131, pika 1, shkronja “P”; 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës; nenet 6 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); neni 1, i Protokollit 12 të KEDNJ-së; Karta Evropiane e Autonomisë Vendore; ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (ligji nr. 139/2015); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, që kërkoj pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, që kërkoj rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuarisi është zgjedhur kryetar i Bashkisë së Vaut të Dejes në zgjedhjet e përgjithshme vendore të vitit 2015.

2. Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 10928, datë 5.11.2018, ka caktuar mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme vendore të radhës në datën 30.6.2019. Ky dekret është shfuqizuar nga Presidenti me

dekretin nr. 11199, datë 10.6.2019, me të cilin është caktuar data 13.10.2019, për mbajtjen e zgjedhjeve.

3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vazhduar përgatitjet për mbajtjen e zgjedhjeve vendore në datën 30.6.2019.

4. Misioni vëzhgues i ODIHR-it, në raportin final të datës 5.9.2019, ka konstatuar se zgjedhjet vendore të vitit 2019, u mbajtën në një situatë krize politike dhe institucionale, që vinte nga një antagonizëm i hershëm mes partisë qeverisëse dhe partive opozitare. Këto të fundit ishin tërhequr nga Kuvendi në muajin shkurt të viti 2019 dhe vendosën të mos merrnin pjesë në zgjedhje. Duke shprehur shqetësime për sigurinë publike dhe përgjegjësinë e tij kushtetuese për të mbrojtur pluralizmin, më 10 qershor, Presidenti nxori një dekret përmes të cilit i anulonte zgjedhjet. Kuvendi e deklaroi të pavlefshëm këtë dekret dhe ndërmoi një procedurë hetimore për shkarkimin e Presidentit nga detyra. Atmosfera e ngërçit dhe e pasigurisë juridike mes institucioneve kryesore minoi besimin e publikut te legjitimiteti i zgjedhjeve. Në muajin shkurt, në Tiranë, filluan protesta të vazhdueshme të opozitës kundër Kryeministrit, të cilat u shenjuan shpesh nga dhuna dhe vandalizmi i drejtuar kundër institucioneve shtetërore. Me afrimin e ditës së zgjedhjeve, protestuesit në pjesë të tjera të vendit vunë në shënjestër administratën zgjedhore, me përfshirjen shpesh të akteve të frikësimit, dhunës dhe zjarrvënies, si dhe përplasjeve me Policinë Bashkiake dhe Policinë e Shtetit *(shih Raportin Përfundimtar të Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve vendore të 30 qershorit 2019, në Shqipëri, faqe 3)*.

5. Në datën 27.6.2019, në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejës është organizuar një tubim nga Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Demokracisë, për të shprehur pakënaqësinë për mosrespektimin e dekretit të Presidentit të Republikës që ka ndryshuar datën e zgjedhjeve vendore. Gjatë tubimit ka pasur përplasje midis Policisë së Shtetit dhe pjesëmarrësve në tubim, si dhe iu është vënë zjarri materialeve zgjedhore të KZAZ-së nr. 6 (të vendosur në ambientet e një shkolle), të Bashkisë së Vaut të Dejës.

6. Për këtë ngjarje është paraqitur kallëzimi penal nr. 1248, i vitit 2019, për kryerjen e veprave penale “Dëmtim me dashje i materialit zgjedhor”, “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuara nga nenet 326/a, 151 dhe 236 të Kodit Penal. Në datën 29.6.2019, kërkuesi është pyetur në Drejtorinë e Policisë Qarku Shkodër, në cilësinë e personit që kishte dijeni për veprat penale të lidhura me ngjarjen e datës 27.6.2019, në KZAZ-në nr. 6, të Bashkisë së Vaut të Dejës. Me vendimin nr. 1248, datë 15.7.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur “mosfillimin e procedimit penal” ndaj kërkuesit, me arsyetimin se mungonin elementet e veprës penale.

7. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit të Brendshëm, ka marrë vendimin nr. 445, datë 28.6.2019, “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të bashkisë Vau i Dejës, z. Zef Hila”, me motivacionin “për shkak të shkeljeve të rënda” (vendimi nr. 445/2019). Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 2.7.2019.

8. Zgjedhjet vendore u zhvilluan në datën 30.6.2019, pa pjesëmarrjen e partive kryesore opozitare. Kërkuesi, si përfaqësues i një prej këtyre partive opozitare nuk kandidoi.

9. Në datën 5.7.2019, ai ka paraqitur ankim në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), e cila prej datës 23 mars të vitit 2018, nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor, të parashikuar nga neni 32, pika 1, e ligjit nr. 8577/2000, për shqyrtimin e çështjeve në seancë plenare. Me plotësimin e kuorumit për funksionimin e kolegjeve dhe më pas edhe të Gjykatës, në datën 12.2.2020, u vendos nga Kolegji kalimi i çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 9.2.2021, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. Kërkuesi, Zef Hila, i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimit nr. 445/2019, të Këshillit të Ministrave, duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur se janë cenuar:

10.1 E drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

10.1.1 Standardi i arsytimit, pasi kërkuesi nuk ka kryer asnjë veprim ose mosveprim të paligjshëm, i cili mund të konsiderohet “shkelje e rëndë”, faktet e paraqitura në vendim janë të natyrës penale, kërkuesi nuk është autor i tyre dhe nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi kolektive për veprimet e kryera nga persona të tretë. Po ashtu, në vendimin e shkarkimit nuk është analizuar proporcionaliteti i shkeljeve në raport me masën e dhënë, gjë që bie në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, si dhe mungon arsyetimi i kriterëve ligjorë që përcakton ligji për masën e shkarkimit të kryetarit të bashkisë.

10.1.2 E drejta për t’u dëgjuar, pasi nuk është kërkuar asnjë sqarim nga kërkuesi në shkelje të nenit 10, të ligjit nr. 139/2015, nuk i është dhënë mundësia të dëgjohej e të paraqiste prova, si dhe nuk i është vënë në dispozicion asnjë akt. Këshilli i Ministrave ka vendosur me urgjencë në mbledhje të jashtëzakonshme për shkarkimin e tij, në shkelje të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” (ligji nr. 9000/2003) dhe Rregulloren e Këshillit të Ministrave (Rregullorja).

10.1.3 Prezumimi i pafajësisë, pasi ministri i Brendshëm, përpara mbledhjes, në deklaratën për shtyp, përtej kompetencave të tij, ka njoftuar shkarkimin e kërkuesit, duke e paragjykuar fajësinë e tij. Po kështu, edhe Kryeministri, në të njëjtën datë, ka deklaruar shkarkimin e tij në rrjetet sociale, të shoqëruar nga fotoja e vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin e tij.

10.2 E drejta për të mos u diskriminuar për bindjet politike, e parashikuar në nenin 14 të KEDNJ-së, pasi Këshilli i Ministrave ka marrë vendim shkarkimi vetëm ndaj kërkuesit, ndërkohë që ngjarje të tilla me pasojë edhe më të rënda kanë ndodhur edhe në bashki të tjera të vendit.

10.3 Parimi i decentralizimit dhe ai i autonomisë së pushtetit vendor, si dhe garancitë kushtetuese për funksionimin dhe organizimin e pushtetit vendor, të njohura nga neni 13 i Kushtetutës dhe Karta Evropiane e Autonomisë Vendore, pasi vendimi i Këshillit të Ministrave ka cenuar të drejtën dhe aftësinë efektive të Bashkisë së Vaut të Dejës dhe të kryetarit të saj për të rregulluar dhe drejtuar çështjet publike nën përgjegjësinë e tij.

10.4 Dinjiteti njerëzor, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, drejtësia shoqërore dhe rendi kushtetues, të mbrojtura nga neni 3 i Kushtetutës, pasi kërkuesi është ngarkuar me faj në mënyrë hipotetike për veprime ose mosveprime të kryera nga persona të tjerë.

10.5 Parimet e ligjshmërisë, shtetit të së drejtës dhe hierarkisë së normave, të sanksionuara në nenet 4 dhe 116, të Kushtetutës, pasi mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit të Ministrave që ka vendosur për shkarkimin e kërkuesit është mbajtur në kundërshtim me Rregulloren dhe ligjin nr. 9000/2003, për sa i përket vlerësimit të urgjencës dhe zbatimit të kriterëve procedurale.

10.6 E drejta e tubimit dhe organizimit, si dhe *liria e shprehjes,* të garantuara nga nenet 47 dhe 22, të Kushtetutës, pasi tubimi është organizuar nga persona të tjerë, të cilët kanë shprehur pakënaqësinë e tyre ndaj mosrespektimit të dekretit të Presidentit për ndryshimin e datës së mbajtjes së zgjedhjeve vendore.

11. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur argumentet si vijon:

11.1 Vendimi nr. 445/2019, është i arsyetuar, pasi relacioni shpjegues i tij jep arsyet e shkarkimit dhe tregon se Këshilli i Ministrave ka respektuar nenet 100 dhe 115, të Kushtetutës, si dhe nenin 62/a, të ligjit nr. 139/2015. Kërkuesi ka kryer shkelje të rënda lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve në datën e caktuar, duke krijuar një situatë kaosi dhe pasigurie në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejes, me episode të përsëritura dhe pasoja të rënda për interesin publik. Vendimi i shkarkimit është proporcional për të parandaluar situatën kaotike dhe për të siguruar mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

11.2 Vendimmarrja e Këshillit të Ministrave nuk ka cenuar të drejtën për t'u dëgjuar të kërkuesit për shkak të urgjencës së situatës së krijuar në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejes dhe cenimit të interesit publik. Vlerësimi i urgjencës është në diskrecion të Këshillit të Ministrave. Neni 89, i Kodit të Procedurave Administrative (KPA), parashikon se në rastet e urgjencës përjashtohet mundësia e palëve për t'u dëgjuar. Megjithatë, vendimi i shkarkimit është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 2.7.2019, si dhe i është dërguar Bashkisë së Vaut të Dejes nga ministri i Brendshëm, me shkresën nr. 3346/2, datë 19.7.2019. Relacioni shpjegues nuk i është dhënë kërkuesit, pasi ai nuk ka paraqitur asnjë kërkesë të tillë.

11.3 Parimet e decentralizimit dhe të autonomisë vendore nuk janë cenuar, pasi njësitë e qeverisjes vendore, gjatë veprimtarisë së tyre, duhet të respektojnë Kushtetutën, ligjet dhe aktet e tjera të nxjerra në zbatim të tyre. Kërkuesi ka kryer shkelje të rënda, që dëmtojnë imazhin e zyrtarit publik dhe janë të lidhura ngushtë me ushtrimin e rregullt të funksionit të tij, duke përmbushur kushtet për shkarkimin e tij nga Këshilli i Ministrave sipas ligjit nr. 139/2015.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

12. Neni 115 i Kushtetutës, në pikat 1 dhe 2, të tij parashikon se organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësisë qeverisëse vendore, mund të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve dhe se ai mund të ankohet për këtë shkarkim në Gjykatën Kushtetuese brenda 15 ditëve.

13. Gjykata është shprehur në jurisprudencën e saj se një gjykim, i cili ka për objekt shkarkimin nga detyra të organeve të qeverisjes vendore, është gjykim në themel i kërkesës. Gjykata Kushtetuese, si organ kontrolli, për të çmuar shkeljen e rëndë të Kushtetutës ose ligjit heton dhe gjykon në themel çështjen, ashtu siç do të vepronte një gjykatë e sistemit gjyqësor të zakonshëm (*shih vendimet nr. 15, datë 8.6.2009; nr. 22, datë 7.10.2008; nr. 39, datë 29.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata konstaton se kërkuesi nuk ka kandiduar për t'u zgjedhur në zgjedhjet e përgjithshme vendore të zhvilluara më 30 qershor 2019 dhe pas zhvillimit të tyre, detyrën e kryetarit të Bashkisë së Vaut të Dejes e ka marrë një shtetas tjetër. Në kohën kur Këshilli i Ministrave ka vendosur shkarkimin nga detyra të kërkuesit, mandati i tij si organ i zgjedhur i qeverisjes vendore ishte drejt përfundimit. Megjithatë, pavarësisht këtyre rrethanave të pranuar edhe nga kërkuesi, ai gjatë seancës plenare ka parashtruar se ka interes në shqyrtimin e ankimit të tij në drejtim të rivendosjes së integritetit, që sipas tij i është cenuar si pasojë e shkarkimit nga detyra në mungesë të kryerjes së shkeljes së rëndë. Legjislacioni, prej vitit 2015 e në vijim, ka pësuar ndryshime në drejtim të standardeve të larta të integritetit dhe shkeljet disiplinore konsiderohen si kriter ndalues për zgjedhjen ose emërimin në pozicione të ndryshme publike, prandaj, ai ka interes të ligjshëm t'i drejtohet Gjykatës për të rivendosur integritetin e tij në këtë drejtim dhe për të eliminuar pengesat eventuale në të ardhmen për të mbajtur pozicione publike.

15. Gjykata, në kontekstin e argumenteve të parashtruara nga kërkuesi për interesin e ligjshëm, sjell në vëmendje edhe raportet që ekzistojnë midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, duke pohuar se shkarkimi nga detyra ose shpërndarja e organeve të qeverisjes vendore është një masë ndërhyrjeje që ushtrohet mbi këto organe nga qeverisja qendrore, për rrjedhojë procedura dhe kriteret e përcaktuara nga neni 115 i Kushtetutës duhet të zbatohen në funksion të autonomisë vendore.

16. Për sa më sipër, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin që subjekti i interesuar nuk ka paraqitur asnjë prapësim mbi interesin e ligjshëm të kërkuesit, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet në këtë gjykim kushtetues, pasi justifikon interesin e ligjshëm, e ka paraqitur kërkesën brenda afatit 15 - ditor të parashikuar nga neni 115 i Kushtetutës, si dhe në themel ngre pretendime që lidhen me procedurën dhe kriteret e shkarkimit të tij nga detyra.

B. Për themelin e pretendimeve

17. Gjykata ka pohuar se gjatë ushtrimit të kontrollit kushtetues të aktit të shkarkimit të organit të qeverisjes vendore, sipas nenit 115 të Kushtetutës, ajo, fillimisht, duhet të vlerësojë nëse organi procedues, Këshilli i Ministrave, i ka respektuar kërkesat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, dhe, më pas, çmon bazueshmërinë/meritën e aktit të shkarkimit (*shih vendimin nr. 29, datë 27.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Kërkuesi, krahas pretendimeve kryesore për mosrespektimin e procesit të rregullt ligjor dhe të kriterëve të shkarkimit nga detyra, ka pretenduar edhe cenimin e dinjitetit të njeriut, të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, drejtësisë shoqërore, rendit kushtetues, parimeve të ligjshmërisë, shtetit të së drejtës dhe hierarkisë së normave, të drejtës së tubimit dhe organizimit, si dhe lirisë së shprehjes. Gjykata, duke iu referuar mënyrës se si janë paraqitur këto pretendime, vlerëson se ato shërbejnë si argumente të lidhura ngushtë dhe në funksion të pretendimeve të kërkuesit për procesin e rregullt ligjor dhe për masën e shkarkimit nga detyra, sipas nenit 115 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, ndonëse në themel të ankimit kërkuesi ka paraqitur një listë pretendimesh, Gjykata do t'i analizojë ato të grupuara në dy drejtime: i. për procesin e rregullt ligjor; dhe ii. për masën e shkarkimit nga detyra.

B.1 Për të drejtën për një proces të rregullt ligjor

19. Kërkuesi pretendon se vendimi i shkarkimit të tij nga detyra është rezultat i një procesi të parregullt ligjor, pasi janë cenuar e drejta për t'u dëgjuar, standardi i arsyetimit të vendimit të Këshillit të Ministrave dhe e drejta për t'u prezumuar i pafajshëm.

20. Subjekti i interesuar, duke iu referuar jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, prapëson se për të zgjedhurit vendorë politikë nuk zbatohen garancitë e procesit të rregullt ligjor, të parashikuara nga neni 6 i KEDNJ-së.

21. Gjykata ka pohuar se kur vihet në lëvizje nga organi i zgjedhur vendor, që ankohet ndaj vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin e tij nga detyra, ajo kontrollon nëse gjatë procesit disiplinor administrativ është garantuar përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia e tij, e drejta për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 37, datë 25.7.2013; nr. 32, datë 10.7.2013; nr. 29, datë 27.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata është organi i vetëm që shqyrton ankesën e organit të qeverisjes vendore kundër vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin ose shpërndarjen e tij. Ajo e bën këtë shqyrtim si nga pikëpamja e faktit, ashtu dhe nga pikëpamja e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material e procedural. Gjykimi i çështjeve të tilla ka për objekt një akt administrativ me karakter individual, kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e të cilit e shqyrton drejtpërdrejt Gjykata Kushtetuese. Në çështje të ngjashme, Gjykata e ka vlerësuar aktin e shkarkimit të organit të zgjedhur të njësisë vendore në këndvështrim të procesit të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 32, datë 10.7.2013; nr. 37, datë 25.7.2013; nr. 29, datë 27.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa më lart, në kushtet kur neni 115 i Kushtetutës parashikon në mënyrë të shprehur të drejtën e ankimit në Gjykatën Kushtetuese për procedurën e shkarkimit, që sipas jurisprudencës konstante kushtetuese duhet të përmbushë standardet e procesit të rregullt ligjor, Gjykata çmon se pretendimi i Këshillit të Ministrave se të zgjedhurit vendorë politikë nuk përfitojnë nga garancitë e procesit të rregullt ligjor gjatë procedurës së shkarkimit nga detyra, nuk qëndron.

23. Në vijim, Gjykata do të analizojë aspektet e procesit ligjor të zhvilluar ndaj kërkuesit, sipas pretendimeve të ngritura prej tij.

B.1.1 Për të drejtën për t'u njoftuar dhe për t'u dëgjuar

24. Kërkuesi ka parashtruar se i është cenuar e drejta për t'u dëgjuar, për arsye se Këshilli i Ministrave nuk ka bërë asnjë përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshjen dhe nuk i ka kërkuar informacion ose sqarim kërkuesit lidhur me shkeljet e pretenduara. Atij nuk i është dhënë mundësia të dëgjohej dhe të paraqiste prova, si dhe nuk i janë vënë në dispozicion aktet e domosdoshme të procesit të shkarkimit që është zhvilluar nga Këshilli i Ministrave (akti i propozimit, relacioni i ministrit, njoftimi i mbajtjes së mbledhjes, praktika për miratimin e rendit të ditës, procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Ministrave, regjistrimi audio i mbledhjes kur është marrë vendimi i shkarkimit). Sipas kërkuesit, procesi i shkarkimit është bërë me urgjencë dhe nuk janë respektuar rregullat procedurale të ligjit nr. 9000/2003 dhe të Rregullores.

25. Subjekti i interesuar ka parashtruar se vendimmarrja e tij ka qenë urgjente për shkak të situatës së krijuar në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejës dhe cenimit të interesit publik. Procedura për shqyrtimin dhe miratimin e vendimit nr. 445/2019 i është nënshtruar të gjitha rregullave të parashikuara nga ligji dhe Rregullorja për zhvillimin e një mbledhjeje të jashtëzakonshme, duke pasur parasysh edhe rastet ku sipas ligjit përjashtohet mundësia e palëve për t'u shprehur. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, vendimi i shkarkimit është publikuar në Fletoren Zyrtare në datën 2.7.2019, dhe në datën 19.7.2019, i është dërguar Bashkisë së Vaut të Dejës nga ministri i Brendshëm. Kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për të kërkuar relacionin shoqërues të vendimit të shkarkimit.

26. Gjykata, gjatë shqyrtimit të ankimeve të organeve të qeverisjes vendore ndaj shkarkimit nga detyra, ka theksuar se e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ. Çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu edhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore (*shih vendimet nr. 29, datë 27.6.2013; nr. 37, datë 25.7.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar, gjithashtu, se e drejta për t'u dëgjuar, si pjesë e së drejtës së mbrojtjes, garantohej edhe në procesin administrativ përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia e tij. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe nëpërmjet parashtrimit të argumenteve prej tij, ose avokatit të zgjedhur (*shih vendimin nr. 29, datë 27.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në kushtet kur Gjykata, gjatë shqyrtimit të ankimit sipas nenit 115 të Kushtetutës, verifikon edhe ligjshmërinë e procesit, ajo është shprehur se KPA-ja parashikon se çdokush që ka interes të ligjshëm ka të drejtë të marrë pjesë në procedimin administrativ. Palët pjesëmarrëse në një procedim administrativ janë autoriteti kompetent, nga njëra anë dhe pala e interesuar, nga ana tjetër. Megjithatë, procedimi administrativ nuk zhvillohet përherë në prani të palëve të interesuara dhe jo çdo herë kjo e fundit mund të shprehet lidhur me procedimin. KPA-ja parashikon rastet kur përjashtohet mundësia e palëve për t'u shprehur, mes të cilave edhe kur palët e interesuara kanë

pasur rast t'i japin mendimet e tyre për çështjet që kanë rëndësi për marrjen e vendimit (*shih vendimin nr. 29, datë 27.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata vëren se jurisprudenca e mësipërme është zhvilluar duke analizuar nenet 44, 93 dhe 96, të KPA-së, të miratuara me ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, i cili tashmë është shfuqizuar me ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative". Megjithatë, jurisprudenca e mësipërme është e zbatueshme edhe pas këtij ndryshimi ligjor, pasi kodi aktual bazohet në të njëjtat parime themelore të procedimit administrativ dhe përmban rregulla me përmbajtje të ngjashme, për sa i takon pjesëmarrjes në procedim dhe së drejtës së palës për t'u dëgjuar (*shih nenet 33, 42, 45, 47, 88 dhe 89, të KPA-së*).

29. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se relacioni i ministrit të Brendshëm dhe vendimi nr. 445/2019 i Këshillit të Ministrave për shkarkimin e kërkuesit nga detyra mbajnë të njëjtën datë, konkretisht datën 28.6.2019 dhe i referohen ngjarjes së ndodhur në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejës në datën 27.6.2019. Vendimi i shkarkimit është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 2.7.2019, ndërsa kërkuesit i është komunikuar me shkrim në datën 19.7.2019.

30. Faktet e mësipërme tregojnë se procedura e shkarkimit është realizuar brenda 24 orëve, pra nga pikëpamja kohore është karakterizuar nga urgjenca, në vijim publikimi i aktit të shkarkimit është zhvilluar me procedurë normale, ndërsa kërkuesi është njoftuar individualisht pas 21 ditësh. Duke qenë se procedura e shkarkimit është zhvilluar në mënyrë urgjente, kërkuesi nuk rezulton të jetë njohur paraprakisht me shkeljet të cilat i janë atribuuar, në mënyrë që, në një ballafaqim procedural, të mund të paraqiste kundërshtimet e tij ndaj këtyre shkeljeve. Pra, atij nuk i është dhënë mundësia të realizojë të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur shpjegime, në kuadrin e procesit të rregullt ligjor. Pyetjes së Gjykatës në këtë drejtim, subjekti i interesuar iu përgjigj në seancë plenare se nuk kishte pasur asnjë komunikim me kërkuesin, qoftë edhe me mjete teknologjike, që mund të garantonin shpejtësinë e njoftimit.

31. Në këtë situatë, Gjykata do të analizojë nëse në rastin konkret ka pasur vend për të zbatuar një prej përjashtimeve nga e drejta për t'u dëgjuar sipas nenit 89 të KPA-së, që parashikon se procedura administrative mund të mbyllet pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t'u dëgjuar, kur marrja e vendimit përfundimtar është urgjente, për shkak të dëmit që mund t'i vijë interesit publik nga vonesa.

32. Subjekti i interesuar ka parashtruar se vendimi i shkarkimit është marrë në një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit të Ministrave dhe në kushtet e urgjencës për shkak të situatës së krijuar në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejës. Sipas tij, është zbatuar përjashtimi ligjor nga e drejta për t'u dëgjuar, i parashikuar nga neni 89 i KPA-së, pasi në rastin konkret është cenuar interesi publik nga dhuna e shkaktuar ndaj policëve, djegia e materialeve zgjedhore dhe mosmarrja e asnjë mase administrative nga kërkuesi ndaj punonjësve të Bashkisë së Vaut të Dejës, të cilët në mënyrë të përsëritur kanë bllokuar disa akse rrugore. Për të mbështetur këtë pretendim, Këshilli i Ministrave ka parashtruar fillimisht se dispononte informacion të klasifikuar sekret shtetëror që tregonte cenimin e interesit publik. Pasi iu dha koha e nevojshme nga Gjykata për të deklasifikuar informacionin, ai e paraqiti në gjykim dhe nga përmbajtja rezultoi se bëhej fjalë për një raport të hartuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me të njëjtën përmbajtje faktike që ishte pasqyruar në relacionin shoqërues të vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin nga detyra të kërkuesit, i cili nuk ishte klasifikuar asnjëherë si sekret shtetëror.

33. Kërkuesi ka prapësuar pretendimin për kushtet e urgjencës, duke parashtruar disa argumente. Kështu, sipas tij, ndjekja e procedurës urgjente administrative nuk mund të përdoret, sepse nuk ka asnjë efekt, pasi shkarkimi nga detyra i kryetarit të bashkisë pezullohet me paraqitjen e ankimit në Gjykatën Kushtetuese. Nga ana tjetër, sipas kërkuesit, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë vendimin nr.

445/2019, për shkarkimin nga detyra të kërkuarit në shkelje të procedurave të përcaktuara nga ligji nr. 9000/2003, pasi mbledhja nuk është zhvilluar fare.

34. Gjykata vëren se nenin 14, i ligjit nr. 9000/2003, lejon mbledhjet e jashtëzakonshme të Këshillit të Ministrave, në raste të veçanta, kur thirret nga Kryeministri ose, në mungesë dhe me porosi të tij, edhe nga zëvendëskryeministri. Ndonëse iu kërkuar nga Gjykata, subjekti i interesuar nuk ka paraqitur të dhëna dhe as dokumente për të dëshmuar thirrjen e kësaj mbledhjeje, rendin e ditës, vendin e zhvillimit të saj ose pjesëmarrësit në të, duke pretenduar se aktet që përmbajnë këto të dhëna ekzistojnë, por nuk mund të paraqiten për shqyrtim në Gjykatë, pasi janë të mbrojtura nga konfidencialiteti.

35. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se aktet e paraqitura nga subjekti i interesuar, duke përfshirë edhe shpjegimet në seancë, nuk argumentojnë mjaftueshëm dëmin urgjent që i vinte interesit publik nëse ndaj kërkuarit do të ishte ndjekur një procedurë normale disiplinore, me të cilën t'i jepej koha e duhur për t'u njohur me aktet dhe për të paraqitur shpjegimet e tij. Duke iu referuar situatës faktike, mbi të cilën Këshilli i Ministrave ka bazuar shkarkimin nga detyra të kërkuarit, vihet re se atij i janë atribuuar dy grupe faktesh disiplinore. Grupi i parë përmbledh veprimet e kryera nga kërkuari në cilësinë e kryetarit të bashkisë, konkretisht urdhri për ndërprerjen e veprimtarisë zgjedhore i datës 17.6.2019 dhe aktet e tjera të nxjerra në datën 18.6.2019, për zbatimin e këtij urdhri, të cilat megjithëse janë veprime të lidhura me funksionin e tij si organ i qeverisjes vendore, nuk e justifikojnë urgjencën dhe përjashtimin nga e drejta për t'u dëgjuar, sipas nenit 89 të KPA-së. Grupi i dytë i fakteve përmbledh veprimet me natyrë penale, të cilat janë kryer në datën 27.6.2019, (konkretisht, dëmtimi me dashje, me anë të zjarrvënies i materialeve zgjedhore dhe kundërshtimi i policisë), për të cilat kompetenca e ndërhyrjes urgjente i takon Policisë së Shtetit dhe prokurorisë.

36. Duke qenë se qëllimi i Këshillit të Ministrave në këtë procedurë urgjente ka qenë ndërprerja ose parandalimi i veprave penale zgjedhore, duhet vënë në dukje se funksioni i ndërprerjes së veprave penale dhe i parandalimit të tyre i përket sferës juridiksionale të kompetencave publike që ushtrohen nga gjykata, prokuroria dhe policia e Shtetit, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale, të cilat, gjithashtu, respektojnë standardet e procesit të rregullt ligjor, duke përfshirë të drejtën për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar dhe për të dhënë shpjegime. Në këtë situatë, Gjykata çmon se procedura urgjente e shkarkimit nga detyra nuk sillte ndikim jo vetëm në drejtëm të administrimit të Bashkisë së Vaut të Dejës, por as në drejtëm të ndërprerjes dhe parandalimit të veprave penale në territorin e kësaj bashkie, për të cilat vepron një mekanizëm i ndryshëm institucional, sipas rregullave ligjore të tjera.

37. Për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se në procesin e shkarkimit të kërkuarit nuk janë respektuar në nivelin minimal e drejta për t'u njoftuar dhe e drejta për t'u dëgjuar, edhe pse nuk rezultojnë të ketë pasur shkak ligjor për të mos respektuar këto të drejta.

B.1.2 Për standardin e arsytimit të vendimit të Këshillit të Ministrave

38. Kërkuari ka pretenduar se vendimi nr. 445/2019, nuk ka respektuar standardin e arsytimit, pasi ai nuk ka kryer asnjë veprim ose mosveprim të paligjshëm, i cili mund të konsiderohet si "shkelje e rëndë", sipas ligjit nr. 139/2015. Përkundrazi, me vendimin nr. 1248, datë 15.7.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka vendosur "mosfillimin e procedimit penal" ndaj kërkuarit, me arsyetimin se mungojnë elementet e veprës penale. Në vendimin e shkarkimit nuk është analizuar proporcionaliteti i shkeljeve në raport me masën e dhënë ndaj kërkuarit, në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, si dhe mungon arsyetimi i kriterëve ligjore që përcakton ligji për masën e shkarkimit të kryetarit të bashkisë.

39. Subjekti i interesuar ka prapësuar se vendimi nr. 445/2019, është i arsyetuar dhe i shoqëruar nga relacioni shpjegues lidhur me arsyet e shkarkimit të kërkuarit. Ky i fundit, me vendimmarrjet e tij

konkrete, të detajuara në relacionin shpjegues, ka kryer shkelje të rënda, duke mos respektuar vendimin nr. 12/2019, të Kolegjit Zgjedhor për mbajtjen e zgjedhjeve në datën e caktuar dhe duke krijuar një situatë kaosi dhe pasigurie në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejës, me episode të përsëritura dhe pasoja të rënda për interesin publik. Ai ka lejuar punonjësit e administratës së bashkisë të marrin pjesë në grumbullime të paligjshme gjatë orarit të punës dhe të bllokojnë rrugë nacionale, pa marrë asnjë masë ndaj tyre. Gjithashtu, sipas subjektit të interesuar, kërkuesi, pavarësisht se nuk ishte vetë prezent, ka organizuar një grup personash, mes të cilëve edhe familjarë të tij, të cilët kanë hyrë me dhunë në KZAZ-në nr. 6 dhe u kanë vënë zjarrin materialeve zgjedhore.

40. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se në rastin e procedurave të shkarkimit të organeve të zgjedhura vendore, edhe pse relacioni i ministrit të Brendshëm që shoqëron projektvendimin për shkarkim dhe vendimi i Këshillit të Ministrave që miraton shkarkimin e organit të zgjedhur të njësisë së qeverisjes vendore u përkasin dy organeve të ndryshme, ato janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe përfaqësojnë një proces të pandashëm (*shih vendimin nr. 29, datë 27.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Gjykata, gjithashtu, ka vënë në dukje se sipas KPA-së arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Kur arsyetimi është bërë bazuar në informacionet apo propozimet e mëparshme, mund të mjaftojë si arsyetim pranimi i tyre nga ana e organit përgjegjës për marrjen e vendimit përfundimtar dhe, në këto raste, informacionet dhe propozimet e mëparshme janë pjesë përbërëse e aktit (*shih vendimin nr. 29, datë 27.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo jurisprudencë e zhvilluar, duke analizuar nenin 109 të Kodit të Procedurave Administrative, tashmë të shfuqizuar, është e zbatueshme edhe për Kodin e ri të Procedurave Administrative, pasi ky i fundit bazohet në të njëjtat parime themelore të procedimit administrativ dhe përmban rregulla për elementet e detyrueshme të arsyetimit të aktit administrativ, madje duke i zhvilluar edhe më tej detyrimet e organit publik në këtë drejtim (*shih nenet 99–101*). Sipas KPA-së në fuqi, përveç elementeve formale, akti administrativ duhet të jetë i qartë dhe të përmbajë, krahas shpjegimit të situatës faktike mbi të cilën është marrë akti, edhe shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave, bazën ligjore të aktit, një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast, si dhe në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar.

42. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar është bazuar në propozimin e ministrit të Brendshëm, i cili ka hartuar dhe nënshkruar relacionin shpjegues. Ky relacion është bazuar në informacionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Këto dy akte kanë përmbajtje të ngjashme dhe përshkruajnë situatën faktike, mbi bazën e së cilës është marrë vendimi i kundërshtuar, duke shpjeguar veprimtarinë e kërkuesit, të familjarëve të tij dhe të punonjësve të Bashkisë së Vaut të Dejës. Konkretisht, me anë të shkresës nr. 3406, datë 24.6.2019, drejtuar KQZ-së, Komisarariatit të Policisë së Vaut të Dejës dhe Misionit të OSBE/ODIHR, kërkuesi ka kërkuar vendosjen në dispozicion të qytetarëve të ambienteve të KZAZ-së nr. 6 në Bashkinë e Vaut të Dejës në datat 27.6.2019 – 2.7.2019 për organizimin e aktiviteteve të ndryshme artistike, kulturore dhe letrare ose tubimeve, pasi, sipas tij, ka një dekret të Presidentit të Republikës që anulon datën e zgjedhjeve vendore. Më tej, në relacion shpjegohet se nga kryerja e veprimeve hetimore, në datën 27.6.2019, kërkuesi, megjithëse nuk ishte vetë prezent, ka organizuar një grup prej 150–200 personash, duke përfshirë punonjës të Bashkisë së Vaut të Dejës dhe familjarë të tij, të cilët kanë sulmuar punonjësit e policisë dhe u kanë vënë zjarrin materialeve zgjedhore që ndodheshin në KZAZ-në nr. 6. Sipas relacionit, në bazë të informacionit të Policisë së Shtetit, kërkuesi, edhe pse nuk ka marrë pjesë vetë në veprime aktive, në datat 26.4.2019, 2.5.2019 dhe 20.6.2019, ka organizuar/angazhuar punonjësit e Bashkisë së Vaut të Dejës për të bllokuar disa akse rrugore dhe

për të penguar zhvillimin e aktiviteteve elektorale. Për këto arsye, ministri i Brendshëm, në relacionin e tij, ka propozuar shkarkimin e kërkuesit nga detyra, bazuar në nenin 62, shkronja “a”, të ligjit nr. 139/2015.

43. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se në relacionin shpjegues të vendimit të kundërshtuar, përveçse paraqiten si referenca neni 62, shkronja “a”, e ligjit nr. 139/2015, si dhe nenet 100 dhe 115, të Kushtetutës, nuk evidentohen elementet e tjera të arsytimit, që kërkohen nga neni 100 i KPA-së, në mënyrë të veçantë nuk jepet shpjegim i mjaftueshëm pse veprimet e kërkuesit përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve dhe, ajo që është më e rëndësishmja, mungon shpjegimi pse Këshilli i Ministrave ka përdorur diskrecionin për t’u mbledhur dhe vendosur në kushtet e urgjencës.

44. Procesi i shkarkimit fillon me fazën e vlerësimit të shkeljeve nga ministri i Brendshëm dhe përfundon me vendimmarrjen e Këshillit të Ministrave që miraton vlerësimin e bërë nga ministri i Brendshëm. Janë pikërisht këto dy organe të cilat realizojnë, sipas kompetencave përkatëse të tyre, në mënyrë të pashkëputur, procesin administrativ të shkarkimit nga detyra të organeve vendore. Për arsye të rolit të rëndësishëm që ato kanë, duhet të respektojnë me rigorozitet standardet e procesit të rregullt ligjor. Në këtë kontekst, relacioni i ministrit të Brendshëm duhet të hartohet duke mbajtur në konsideratë kërkesat e arsytimit të aktit administrativ të përcaktuar nga KPA-ja, sidomos vlerësimin se përse faktet përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve nga organi i zgjedhur vendor. Këto elemente nuk janë të pasqyruara në mënyrë të mjaftueshme në relacionin e ministrit të Brendshëm, mbi të cilin është bazuar edhe vendimi nr. 445/2019, i Këshillit të Ministrave, për shkarkimin e kërkuesit. Ndërsa, lidhur me urgjencën e rastit, vlerësimi i së cilës siç shpjegoi subjekti i interesuar, është në përgjegjësinë dhe diskrecionin e tij, relacioni nuk përmban asnjë të dhënë, duke mos respektuar detyrimin e përcaktuar shprehimisht nga neni 100, pika 1, shkronja “ç”, i KPA-së. Kjo e metë e arsytimit të aktit është me rëndësi të veçantë, pasi zhvillimi i procedurës urgjente është përdorur nga subjekti i interesuar edhe për t’u shmangur nga detyrimi për të njoftuar dhe dëgjuar kërkuesin, siç u arsyetua më lart në këtë vendim.

45. Për rrjedhojë, nisur nga analiza e mësipërme, Gjykata vlerëson se vendimi i Këshillit të Ministrave për shkarkimin nga detyra të kërkuesit nuk respekton standardin e arsytimit.

B.1.3 Për prezumimin e pafajësisë

46. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se i është cenuar e drejta për t’u prezumuar i pafajshëm, pasi ministri i Brendshëm, në deklaratën për shtyp të datës 28.6.2019, ka deklaruar shkarkimin e kërkuesit. Sipas tij, ky parim zbatohet përtej procesit penal, duke përfshirë edhe procedurat administrative disiplinore.

47. Parimi i prezumimit të pafajësisë garantohet nga neni 30 i Kushtetutës, sipas të cilit kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

48. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se në rastet e shkarkimit të funksionarëve të lartë kushtetues parimet e prezumimit të pafajësisë dhe të paanësisë nuk mund të zbatohen si parime tipike klasike të proceseve gjyqësore, kur organet e ngarkuara me këto procedura, qoftë në përbërjen dhe organizimin e tyre, qoftë në veprimtarinë e funksionet e tyre, nuk mund të jenë organe gjyqësore, nuk ushtrojnë pushtet gjyqësor, por ushtrojnë pushtete të tjera të ndryshme (*shih vendimin nr. 21, datë 1.10.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Duke iu referuar jurisprudencës së mësipërme, Gjykata çmon se Këshilli i Ministrave, kur shkarkon nga detyra organin e zgjedhur të qeverisjes vendore, zhvillon një proces administrativo-disiplinor, i cili ka parimet e veta që lidhen me verifikimin, analizën dhe vërtetimin e shkaqeve konkrete që i kanë shërbyer organit kompetent për të marrë masën e shkarkimit. Ky proces duhet të respektojë standardet e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga Kushtetuta dhe ligji (*shih paragrafët 21–22, të këtij vendimi*). Megjithatë, parimi i prezumimit të pafajësisë nuk gjen zbatim si në

procesin gjyqësor penal, jo vetëm për shkak të natyrës administrativo-disiplinore të këtij procesi, por edhe për shkak të përbërjes dhe funksioneve politike të Këshillit të Ministrave.

50. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i pabazuar.

B.2 Për masën e shkarkimit nga detyra

51. Kërkuesi pretendon se është shkarkuar nga detyra e kryetarit të bashkisë në mungesë të shkaqeve të parashikuara nga neni 115, pika 1, i Kushtetutës, pasi ai nuk ka kryer asnjë shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve, siç e kërkon kuadri ligjor për shkarkimin e tij. Përkundrazi, ai argumenton se është shmangur publikisht nga aktet e dhunës dhe u ka bërë thirrje qytetarëve për qetësi dhe vetëpërmbytje, duke kërkuar të mos dëmtohej prona dhe interesat e qytetarëve. Kërkuesi pretendon se motivacioni i shkarkimit të tij bazohet në veprime ose mosveprime të karakterit penal, çka nuk përbën shkak për shkarkim nga Këshilli i Ministrave, pa pasur më parë një vendim penal të formës së prerë me të cilin kërkuesi të ishte shpallur fajtor për kryerjen e një vepr penale. Ai pretendon se nuk ka qenë fare në vendngjarje kur është djegur shkolla dhe materialet zgjedhore. Sipas tij, shkarkimi nga detyra ka motivacion politik dhe është arbitrar. Kërkuesi pretendon se është diskriminuar për arsye politike, pasi Këshilli i Ministrave nuk ka kryer hetimin e duhur përpara se të merrte vendimin e shkarkimit.

52. Subjekti i interesuar prapëson duke argumentuar se kërkuesi ka kryer shkelje të rënda kushtetuese, pasi ka vepruar për pengimin e procesit zgjedhor vendor të caktuar në datën 30.6.2019, duke shkelur në këtë mënyrë nenin 109 të Kushtetutës për periodicitetin e zgjedhjeve vendore. Sipas tij, kërkuesi, me urdhrin nr. 151, datë 17.6.2019, ka urdhëruar ndërprerjen e veprimtarisë zgjedhore të çdo lloji për të gjithë subjektet në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejës. Ky urdhër i është dërguar Komisarariatit të Policisë së Vaut të Dejës me qëllim ndërprerjen e funksionimit të KZAZ-së nr. 6 dhe KQZ-së, me qëllim tërheqjen e materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja nr. 6. Ai e ka nxjerrë këtë urdhër pa marrë parasysh rezolutën e Kuvendit, qëndrimin e KQZ-së dhe vendimin nr. 12/2019, të Kolegjit Zgjedhor, sipas të cilave zgjedhjet vendore do të zhvilloheshin në datën 30.6.2019. Gjithashtu, nga aktet e administruara nuk rezulton që kërkuesi të ketë marrë masa administrative ndaj punonjësve të Bashkisë së Vaut të Dejës, të cilët kanë bllokuar në disa raste akse të rëndësishme rrugore ose janë përfshirë në ngjarjen e ndodhur në KZAZ-në nr. 6. Këto veprime, të cilat kanë qenë në kundërshtim me vendimmarrjen e institucioneve shtetërore, kanë dëmtuar rëndë imazhin e organit të zgjedhur vendor, sepse janë të lidhura me përmbytjen e rregullt të detyrës nga ana e kërkuesit.

53. Në lidhje me këtë pretendim të kërkuesit dhe prapësimet e subjektit të interesuar, Gjykata, gjatë votimit të çështjes, nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj të kërkuar nga dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore. Sipas nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, Gjykata merr vendim përfundimtar me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj. Kjo dispozitë kushtetuese është reflektuar edhe në përmbytjen e nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit vendimet e saj merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të saj dhe abstenimi nuk lejohet. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, në kushtet kur nuk është formuar shumica e kërkuar prej 5 votash, ky pretendim konsiderohet i rrëzuar¹.

¹ Votuan pro pranimit të këtij pretendimi gjyqtarët: Vitore Tusha, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja dhe Përparim Kalo. Votuan kundër pranimit gjyqtarët: Elsa Toska, Fiona Papajorgji dhe Altin Binaj.

54. Si përfundim, Gjykata, bazuar në analizën e të gjitha pretendimeve të kërkuarit, vlerëson se kërkesa e tij duhet pranuar në objektin e saj, pasi është cenuar procesi i rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për t'u njoftuar dhe për t'u dëgjuar, si dhe të standardit të arsytimit të vendimit.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 115, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 445, datë 28.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë së Vaut të Dejës, z. Zef Hila".

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 10.5.2021.

Shpallur më 4.6.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Përparim Kalo, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja

Anëtarë pjesërisht kundër: Fiona Papajorgji, Elsa Toska

Anëtarë kundër: Altin Binaj

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën për përfundimin e arritur në këtë çështje lidhur me pretendimin për cenimin e standardit të arsytimit, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

2. Shumica ka arsyetuar, ndër të tjera, se në relacionin shoqërues të vendimit të kundërshtuar, përveçse paraqiten si referenca neni 62, shkronja "a", i ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (ligji nr. 139/2015), si dhe nenet 100 dhe 115 të Kushtetutës, nuk evidentohen elementet e tjera të arsytimit, që kërkojnë nga neni 100 i KPA-së, e, në mënyrë të veçantë nuk jepet shpjegim i mjaftueshëm pse veprimet e kërkuarit përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve dhe, ajo që është më e rëndësishmja, mungon shpjegimi pse Këshilli i Ministrave ka përdorur diskrecionin për t'u mbledhur dhe vendosur në kushtet e urgjencës (...) Procesi i shkarkimit fillon me fazën e vlerësimit të shkeljeve nga ministri i Brendshëm dhe përfundon me vendimmarrjen e Këshillit të Ministrave që miraton vlerësimin e bërë nga ministri i Brendshëm. Janë pikërisht këto dy organe të cilat realizojnë, sipas kompetencave përkatëse të tyre, në mënyrë të pashkëputur, procesin administrativ të shkarkimit nga detyra të organeve vendore. Për arsye të rolit të rëndësishëm që ato kanë, duhet të respektojnë me rigorozitet standardet e procesit të rregullt ligjor. Në këtë kontekst, relacioni i ministrit të Brendshëm duhet të hartohet duke mbajtur në konsideratë kërkesat e arsytimit të aktit administrativ të përcaktuara nga KPA-ja, sidomos vlerësimin se përse faktet përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve nga organi i zgjedhor vendor. Këto elemente

nuk janë të pasqyruara në mënyrë të mjaftueshme në relacionin e ministrit të Brendshëm, mbi të cilin është bazuar edhe vendimi nr. 445/2019, i Këshillit të Ministrave, për shkarkimin e kërkuesit. Ndërsa, lidhur me urgjencën e rastit, vlerësimi i së cilës, siç shpjegoi subjekti i interesuar, është në përgjegjësinë dhe diskrecionin e tij, relacioni nuk përmban asnjë të dhënë, duke mos respektuar detyrimin e përcaktuar shprehimisht nga neni 100, pika 1, shkronja “ç”, i KPA-së. Kjo e metë e arsyetimit të aktit është me rëndësi të veçantë, pasi zhvillimi i procedurës urgjente është përdorur nga subjekti i interesuar edhe për t’u shmangur nga detyrimi për të njoftuar dhe dëgjuar kërkuesin, siç u arsyetua më lart në këtë vendim (*shih paragrafët 43 dhe 44, të vendimit*).

3. Nga relacioni i ministrit të Brendshëm “Për projektvendimin “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë së Vaut të Dejës, z. Zef Hila””, bashkëshoqërues i procesit të vendimmarrjes dhe shkarkimit, konstatohet se ai përmban:

3.1 - qëllimin e synuar nga ky projektvendim, konkretisht shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë së Vaut të Dejës, z. Z.H.;

3.2 - bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur propozimi për shkarkimin e tij (neni 62, pika “a”, i ligjit nr. 139/2015);

3.3 - faktet konkrete, në lidhje me veprimet e kundërligjshme të kryera në datën 27.6.2019, në Bashkinë e Vaut të Dejës, për të cilat është vlerësuar përgjegjësia e kryetarit të kësaj bashkie. Kështu, konkretisht, ministri i Brendshëm ka arsyetuar:

“Me datë 24.6.2019, me anë të shkresës nr. 3406, të Bashkisë Vau-Dejës, nënshkruar nga kryetari i kësaj Bashkie Zef Hila, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Komisariatit të Policisë Vau-Dejës dhe Misionit të OSBE/ODIHR, ndër të tjera, ka bërë më dije se nga data 27 qershor 2019 deri në 2 korrik 2019, në kushtet kur ka një dekret të Presidentit që anulon zgjedhjet, kërkon që ambientet ku ndodhet KZAZ-ja nr. 6 e Bashkisë Vau-Dejës të jetë në dispozicion të qytetarëve për aktivitete të ndryshme artistike, kulturore dhe letrare, apo për tubime që do të organizohen në përputhje me të drejtën kushtetuese të lirisë së tubimit, sipas nenit 47 të Kushtetutës. Nisur nga kjo shkresë dhe e gjithë situata në fushatën zgjedhore në gjithë territorin e Qarkut Shkodër, në bashkitë e saj janë marrë masat për ruajtjen e KZAZ-ve, si para se të vinin materialet zgjedhore edhe në momentin kur janë vendosur në të gjitha KZAZ-të e miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në KZAZ-në nr. 6, të Bashkisë Vau-Dejës, e cila ndodhet e vendosur në palestrën e shkollës së mesme profesionale “Ndre Mjeda”, shkollë e cila është në një ambient të hapur dhe e parrethuar në të gjithë hapësirën e saj, nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër janë rritur masat e sigurisë duke vendosur shtim të forcave policore për ruajtjen e tyre.

Me datë 27.6.2019, në orën 20.00, një grup prej 150–200 personash, të organizuar nga kryetari i Bashkisë Zef Hila, i cili nuk ishte prezent vetë, ka drejtuar dhe ka dërguar njerëzit e tij më të afërt, duke i dërguar drejt ambienteve të KZAZ-së. Ky grup personash drejtohej dhe udhëhiqej nga autoritetet drejtuese dhe përfaqësuesit më të lartë të Bashkisë Vau-Dejës që janë z.v./kryetari i Bashkisë Vau-Dejës A. H., sekretari i Bashkisë G. N., kryetari i Njësisë Administrative H. B. N, si dhe shumë punonjës të tjerë të bashkisë. Këta persona pasi bënë një takim formal me shefin e Komisariatit të Policisë Vau-Dejës, në mënyrë të menjëhershme e kanë shtyrë dhe janë sulur drejt punonjësve të tjerë të policisë, ku ka pasur një sulm me veprime aktive, të drejtpërdrejta duke i shtyrë, goditur, me qëllim që t’i largonin dhe të hynin brenda në ambientin e KZAZ-së. Personat kanë hedhur në drejtim të forcave të policisë mjete piroteknike, bomba molotov (shishe me benzinë të lidhura me kapsolla që shpërthejnë dhe kthehen në rrezik potencial për jetën pasi përhapet flaka), ku si pasojë e hedhjes së tyre, 4 punonjës policie kanë mbetur të plagosur. Gjithashtu, kanë hedhur molotov edhe nga dritaret e jashtme të palestrës ku i kanë vënë zjarrin gjithë materialeve zgjedhore që ndodheshin brenda KZAZ-së.

Nga kryerja e veprimeve hetimore rezulton se personat e implikuar dhe personat përgjegjës për këtë ngjarje të rëndë kriminale janë përfaqësuesit kryesorë të bashkisë, si dhe familjarët e afërm të Kryetarit të Bashkisë Vau-Dejës Zef Hila. Në lidhje me këtë ngjarje midis personave të tjerë zyrtarë të Bashkisë Vau-Dejës është bërë arrestimi i shtetasit

A. K. H. (vëllai i kryetarit të Bashkisë), si dhe është shpallur në kërkim shtetasi E. Z. H. (djali i kryetarit të Bashkisë Vau-Dejës).

Gjithashtu, kryetari i Bashkisë Zef Hila duke mos marrë pjesë në veprime aktive, por duke nxjerrë funksionarët e tjerë të Bashkisë, si z.v/ kryetarin A. H., Sekretarin e Bashkisë G. N., si dhe të gjithë kryetarët e njësisë vendore dhe punonjës të tjerë të Bashkisë Vau-Dejës, me datë 20.6.2019, ka organizuar bllokimin e rrugës nacionale Lezhë-Shkodër, gjatë vizitës që do të bënin autoritetet e larta shtetërore, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, me qëllim që të pengonin takimet elektorale.

Me datë 2.5.2019, në protestën e organizuar nga subjekti politik PD, është bllokuar rruga nacionale në aksin Shkodër-Lezhë në Kryebushat dhe të organizuar nga funksionarët e Bashkisë Vau-Dejës, kanë bllokuar këtë aks rrugor.

Gjithashtu, me datë 26.4.2019, gjatë vizitës që do të bënin autoritetet e larta shtetërore, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë në qarkun Shkodër në aksin rrugor Vau Dejës – Shkodër, në fshatin Mjedë, po këta persona të lartpërmendur, nën drejtimin e Zef Hilës, kanë tentuar të bllokojnë rrugën.

Sipas informacionit të Policisë së Shtetit, rezulton se personat e implikuar dhe personat përgjegjës për këto ngjarje të rënda kriminale janë përfaqësuesit kryesorë të bashkisë, si dhe familjarë të afërm të kryetarit të bashkisë Vau-Dejës, z. Zef Hila.

Veprimet e përsëritura të kryetarit të Bashkisë Vau-Dejës janë në kapërcim të kompetencave dhe në shkelje të hapur të ligjit. Tentativat e tij për të prishur procesin zgjedhor përmes angazhimit të përsëritur të punonjësve të bashkisë në bllokimin e dhunshëm të qarkullimit rrugor në akse kombëtare dhe në sulmet e organizuara kundër KZAZ e bëjnë shkarkimin e z. Zef Hila një lëvizje të pashmangshme.”.

4. Po kështu, vendimi nr. 445/2019, i Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 100 dhe 115, pika 1, të Kushtetutës dhe nenin 62, shkronja “a”, të ligjit nr. 139/2015, duke reflektuar të gjithë bazën ligjore të nevojshme për vendimmarrjen.

5. Nga sa më lart, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se të dhënat e mësipërme e plotësojnë standardin e një arsyetimi të mjaftueshëm në raport me qëllimin dhe funksionin që ka ky standard, sikundër janë: e drejta e funksionarit për të marrë dënimin për të gjitha arsyet e shkarkimit, e drejta për ankim efektiv në Gjykatën Kushtetuese, kontrolli efektiv dhe substancial i Gjykatës Kushtetuese për standardin e arsyetimit, bazuar në argumentet e dhëna në këtë proces, si dhe detyrimi për transparencë dhe vëzhgimi publik i veprimtarisë së Këshillit të Ministrave për të gjithë të interesuarit që duan të marrin dënimin për procese të kësaj natyre.

6. Nga ana tjetër, ashtu siç pranon edhe shumica, në seancën gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës nga Gjykata Kushtetuese, subjekti i interesuar ka parashtruar si argument shtesë, edhe se kërkuar ka vepruar për pengimin e procesit zgjedhor vendor të caktuar në datën 30.6.2019, duke shkelur në këtë mënyrë nenin 109 të Kushtetutës, për periodicitetin e zgjedhjeve vendore, si dhe nuk ka marrë parasysh detyrimin e bashkisë për zbatimin e vendimeve të KQZ-së dhe të Kolegjit Zgjedhor për datën e zgjedhjeve (*shih procesverbalin e seancës gjyqësore*).

7. Në këtë drejtim, theksojmë se roli i Gjykatës Kushtetuese, si gjykatë kontrolli ndaj vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave është jo vetëm garantimi i të drejtave kushtetuese të kandidatit të shkarkuar nga funksioni drejtues i organit të qeverisjes vendore, por njëkohësisht edhe garantimi i respektimit të nenit 13 të Kushtetutës, për ushtrimin e qeverisjes sipas parimit të autonomisë vendore, i cili njeh jo vetëm pavarësinë e organeve të qeverisjes vendore, por njëkohësisht edhe përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e tyre. Kjo Gjykatë këtë detyrë do ta kryente për shkak të funksionit themelor dhe të posaçëm në këtë lloj procesi, ku ajo nuk do të duhej të garantonte vetëm të drejtat e funksionarit të shkarkuar, por edhe interesin publik që kjo detyrë mbart, në drejtim të mbrojtjes së vlerave, si përgjegjësia dhe llogaridhënia e këtyre funksionarëve në ushtrim të detyrës, në përputhje me neni 13 të Kushtetutës.

8. Nisur nga sa më lart, Gjykata kontrollon vlefshmërinë e aktit të shkarkimit, si nga pikëpamja e faktit, ashtu edhe nga pikëpamja e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material e procedural. Pra, në këto raste, Gjykata Kushtetuese heton dhe gjykon në themel çështjes, ashtu siç do të vepronte një gjykatë e sistemit gjyqësor të zakonshtëm. Gjatë këtij gjykimi kjo gjykatë, kontrollon të gjitha standardet e parashikuara nga Kushtetuta në lidhje me këtë proces.

9. Për rrjedhojë, vlerësojmë se argumenti shtesë i paraqitur nga subjekti i interesuar, pavarësisht se nuk përbën pjesë të argumenteve në relacionin e ministrit të Brendshëm, dhe nuk është cilësuar në përmbajtje të vendimit nr. 445/2019, të Këshillit të Ministrave, përmes të cilit është vendosur shkarkimi i kërkuesit nga detyra e kryetarit të Bashkisë së Vaut të Dejës, nuk mund të mos merret parasysh për efekt të plotësimit të standardit të arsytimit të këtij vendimi.

10. Duke iu kthyer qëndrimit të shumicës, ajo shprehet se në relacionin shoqërues të vendimit të kundërshtuar, përveçse paraqitet si referencë neni 62, shkronja “a”, i ligjit nr. 139/2015, si dhe nenit 100 dhe 115 të Kushtetutës, mungojnë elementet e tjera të arsytimit, që kërkohen nga neni 100 i KPA-së, në mënyrë të veçantë nuk jepet shpjegimi pse veprimet e kërkuesit përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve dhe ajo që është më e rëndësishmja, shpjegimi se përse Këshilli i Ministrave ka përdorur diskrecionin për t’u mbledhur dhe vendosur në kushtet e urgjencës. *(prg. 43 i vendimit)*.

11. Në lidhje me këto argumente të shumicës, vlerësojmë se: - së pari, shpjegimet se pse veprimet e kërkuesit përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve, nuk mungojnë. Konkretisht në këtë aspekt, në relacionin e ministrit të Brendshëm, parashikohet: *“Veprimet e përsëritura të kryetarit të Bashkisë Vau-Dejës janë në kapërcim të kompetencave dhe në shkelje të hapur të ligjit. Tentativat e tij për të prishur procesin zgjedhor përmes angazhimit të përsëritur të punonjësve të bashkisë në bllokimin e dhunshëm të qarkullimit rrugor në akse kombëtare dhe në sulmet e organizuara kundër KZAZ e bëjnë shkarkimin e z. Zef Hila një lëvizje të pashmangshme.”*; - së dyti, është e vërtetë që KPA-ja, në nenin 100, pika 1, shkronja “ç”, kërkon që, në rastin e diskrecionit, akti të përmbajë shpjegimin se pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e caktuar, sikundër edhe shumica e analizon *(shih paragrafin 44 të vendimit)*. Megjithatë, në vlerësimin e pakicës, mosndjekja në mënyrë rigoroze dhe strikte e standardit të arsytimit sipas nenit 100, pika 1, shkronja “ç”, ku do të duhej të arsyetohej edhe urgjenca, nuk sjell asnjë cenim të mjaftueshmërisë së standardit të arsytimit, i cili lidhet thelbësisht me detyrimin për arsyetim të elementëve të kërkuar nga shkronjat “a” (shpjegimi i situatës faktike mbi të cilën është marrë akti), “b” (shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave), dhe “c” (bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast), të nenit 100, që Këshilli i Ministrave i ka respektuar. Për më tepër, që ky arsyetim, sikundër theksuam dhe më lart, është plotësuar edhe me argumente shtesë në seancën gjyqësore para Gjykatës Kushtetuese.

12. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në këtë drejtim ka theksuar se një shqyrtim i çështjes nga një autoritet administrativ, i cili në disa aspekte nuk përputhet me kriteret e kërkuara të nenit 6, nuk mund të konsiderohet shkelje e Konventës, për sa kohë që vendimmarrja e këtij organi shqyrtohet nga një organ gjyqësor me “juridiksion të plotë” dhe që garanton elementet e kërkuara të nenit 6/1 të KEDNJ-së *(shih vendimet e GJEDNJ-së, Albert de la Compte kundër Belgjikës, kërkesat nr. 7299/75 dhe 7496/76, 3 shkurt 2009, § 29; Sigma Radio Television Ltd kundër Qipros, kërkesat nr. 32181/04 dhe 35122/05, 21 korrik 2011, § 151)*.

13. Për të gjitha sa më lart, vlerësojmë se në rastin konkret nuk ka pasur shkelje të standardit të arsytimit nga Këshilli i Ministrave për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë së Vaut të Dejës.

Anëtarë: Altin Binaj, Elsa Toska

MENDIM PAKICE

1. Në përfundim të gjykimit kushtetues të kërkesës së paraqitur nga Zef Hila, me objekt: *“Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 445, datë 28.6.2019, “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë së Vaut të Dejës, z. Zef Hila”, si i papajtueshëm me Kushtetutën”*”, Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës me arsyetimin se në procesin e shkarkimit të kërkuarit nuk janë respektuar në nivelin minimal e drejta për t’u njoftuar dhe e drejta për t’u dëgjuar (*shih paragrafin 37 të vendimit*) dhe se vendimi i Këshillit të Ministrave për shkarkimin nga detyra të kërkuarit nuk respekton standardin e arsytimit (*shih paragrafin 45 të vendimit*).

2. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje, vetëm për sa i përket pretendimit të kërkuarit për cenimin e së drejtës për t’u njoftuar dhe për t’u dëgjuar, e çmojmë të rëndësishme të shprehim argumentet mbi të cilat mbështesim mendimin tonë në pakicë.

3. Kërkuari ka pretenduar, mes të tjerash, cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar për arsye se nga ana e Këshillit të Ministrave nuk është bërë asnjë përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshjen dhe nuk është kërkuar informacion ose sqarim prej tij lidhur me shkeljet e pretenduara. Kërkuarit nuk i është dhënë mundësia të dëgjohej dhe të paraqiste prova, si dhe nuk i janë vënë në dispozicion aktet e domosdoshme të procesit të shkarkimit (akti i propozimit, relacioni i ministrit, procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Ministrave, vendimi i shkarkimit). Sipas tij, procesi i shkarkimit është bërë me urgjencë dhe nuk janë respektuar rregullat procedurale të ligjit nr. 9000/2003 dhe të rregullores së Këshillit të Ministrave.

4. Subjekti i interesuar ka parashtruar se vendimmarrja e Këshillit të Ministrave, në rastin konkret, ka qenë urgjente për shkak të situatës së krijuar në Bashkinë e Vaut të Dejës dhe cenimit të interesit publik. Procedura për shqyrtimin dhe miratimin e VKM-së nr. 445/2019 u është nënshtruar të gjitha rregullave të parashikuara nga ligji nr. 9000/2003 dhe Rregullorja për zhvillimin e një mbledhjeje të jashtëzakonshme, duke pasur parasysh edhe rastet ku sipas ligjit përjashtohet mundësia e palëve për t’u shprehur. Ndryshe nga sa pretendon kërkuari, vendimi i shkarkimit është publikuar në Fletoren Zyrtare në datën 2.7.2019 dhe në datën 19.7.2019, i është dërguar Bashkisë së Vaut të Dejës. Kërkuari nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për të kërkuar relacionin shoqërues të vendimit të shkarkimit.

5. Fillimisht, duam të nënvizojmë faktin se bashkohemi me parimet e theksuara nga shumica, për sa i përket rëndësisë së të drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, jo vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ (*shih paragrafin 26 të vendimit*). Në këtë kuptim, Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur, si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake ashtu edhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore (*shih vendimet nr. 29, datë 27.6.2013; nr. 37, datë 25.7.2013; nr. 76, datë 25.4.2002, të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Po në këtë këndvështrim, Gjykata ka pohuar se e drejta për t’u dëgjuar, si pjesë e së drejtës së mbrojtjes, garantohet edhe në procesin administrativ përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca

dhe rëndësia e tij. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe nëpërmjet parashtrimin të argumenteve prej tij ose avokatit të zgjedhur (*shih vendimin nr. 29, datë 27.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Nga ana tjetër, garancitë që ofrohen gjatë procedimit administrativ janë të parashikuara edhe nga KPA-ja (e miratuar me ligjin nr. 44/2015), i cili në nenin 33 përcakton se palë në procedurën administrative është edhe çdo person ndaj të cilit ka filluar procedura administrative ose të cilit i drejtohet, apo synohet t'i drejtohet vendimi i procedurës administrative. Ndërsa neni 88 i KPA-së parashikon mënyrën e ushtrimit të së drejtës për t'u dëgjuar, e cila bëhet në çdo formë të përshtatshme dhe brenda afatit të përcaktuar nga organi publik.

8. Megjithatë, procedimi administrativ nuk zhvillohet përherë në prani të palëve të interesuara dhe jo çdo herë këto të fundit mund të shprehen për procedimin. Neni 89 i KPA-së parashikon rastet e përjashtimit nga e drejta për t'u dëgjuar, pra kur procedura administrative mund të mbyllet pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës të dëgjohet, mes të cilave edhe kur: a) marrja e vendimit përfundimtar është urgjente, për shkak të dëmit që mund t'i shkaktohet, për shkak të vonesës, interesit publik. Sipas kësaj dispozite ekzistenca e urgjencës, e cila konsiston në dëmin që vjen nga vonesa në interesin publik, është një prej rasteve që justifikon mosrespektimin e së drejtës për t'u dëgjuar.

9. Duke pasur parasysh jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese gjatë shqyrtimit të ankimit sipas nenit 115 të Kushtetutës, si edhe parimet themelore të procedimit administrativ të sanksionuara në KPA, vlerësojmë se në rastin konkret procedura e shkarkimit është zhvilluar në kushtet e urgjencës, çka ka passjellë që kërkuesit nuk i është dhënë mundësia të realizojë të drejtën për t'u dëgjuar.

10. Ashtu sikurse është vërejtur edhe nga shumica, relacioni i ministrit të Brendshëm dhe vendimi nr. 445/2019 i Këshillit të Ministrave, për shkarkimin e kërkuesit nga detyra mbajnë të njëjtën datë, konkretisht datën 28.6.2019 (*shih paragrafin 29 të vendimit*). Nisur nga ky fakt shumica ka arritur në përfundimin se procedura e shkarkimit është realizuar brenda 24 orëve, pra nga pikëpamja kohore është karakterizuar nga urgjenca, ndërsa në vijim publikimi i aktit të shkarkimit është zhvilluar me procedurë normale (*shih paragrafin 30 të vendimit*). Ky fakt mbështetet edhe nga parashtrimet e subjektit të interesuar, i cili ka shpjeguar se vendimi i shkarkimit është marrë në një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit të Ministrave dhe në kushtet e urgjencës për shkak të situatës së krijuar në Bashkinë e Vaut të Dejës. Nga aktet e dosjes dhe rrethanat faktike nuk rezulton që kërkuesi të jetë njohur paraprakisht me shkeljet të cilat i janë atribuuar, në mënyrë që, në një ballafaqim procedural, të mund të paraqiste kundërshtimet e tij ndaj këtyre shkeljeve.

11. Shumica ka klasifikuar në 2 grupe rrethanat e situatës faktike që i janë atribuuar kërkuesit gjatë procedurës së shkarkimit nga detyra. Grupi i parë përmbledh veprimet e kryera nga kërkuesi në cilësinë e kryetarit të bashkisë, konkretisht urdhri për ndërprerjen e veprimtarisë zgjedhore, datë 17.6.2019 dhe aktet e tjera të nxjerra në datën 18.6.2019, për zbatimin e këtij urdhri, kurse grupi i dytë i fakteve përmbledh veprimet me natyrë penale, të cilat janë kryer në datën 27.6.2019, konkretisht, dëmtimi me dashje, me anë të zjarrvënies të materialeve zgjedhore dhe kundërshtimi i policisë. Ajo ka arritur në përfundimin se grupi i parë i fakteve edhe pse janë veprime të lidhura me funksionin e kërkuesit si organ i qeverisjes vendore, nuk e justifikojnë urgjencën dhe përjashtimin nga e drejta për t'u dëgjuar, ndërsa për grupin e dytë kompetenca e ndërhyrjes urgjente i takon Policisë së Shtetit dhe prokurorisë (*shih paragrafin 35 të vendimit*).

12. Në vlerësimin tonë, në ndryshim nga sa konkludon shumica, në rastin konkret ndodhemi në një prej rasteve përjashtimore të parashikuara nga neni 89 i KPA-së, pasi, bazuar në aktet e administruara gjatë këtij gjykimi, rezultojnë një sërë veprimesh dhe mosveprimesh edhe të kryetarit

të bashkisë, para dhe gjatë datës 27.6.2019, të cilat e rënduan situatën e rendit dhe të sigurisë publike në territorin e administruar prej tij gjatë ushtrimit të këtij funksioni.

13. Këto veprime dhe mosveprime nuk janë kryer vetëm në një episod dhe në një ditë të vetme, por ato janë kryer sipas një kronologjie kohore, që vetëm sa ka kulmuar edhe me kryerjen e veprimeve të paligjshme të natyrës juridiko-penale në ngjarjen e datës 27.6.2019, në KZA-në nr. 6, të Bashkisë së Vaut të Dejës.

14. Është pikërisht për shkak të kategorizimit të grupfakteve, sikurse ka konstatuar edhe shumica, kronologjisë dhe pasojave konkrete që ato fakte kanë sjellë, arsyeja për të cilën mendojmë se situata e rendit dhe sigurisë publike, si dhe e mbrojtjes së pronës publike në bashkinë e drejtuar nga kërkuesi janë cenuar rëndë edhe për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të këtij të fundit. Këto fakte justifikojnë bindjen e Këshillit të Ministrave se ajo situatë mund të rëndohej edhe më tej, duke mbajtur në konsideratë rrethana objektive të tilla si: i. kërkuesi kishte kërkuar pezullimin e procesit zgjedhor; ii. kërkuesi kishte kërkuar boshatisjen e KZAZ-së nga materialet zgjedhore; iii, nuk kishte marrë asnjë masë ndaj vartësve të tij të bashkisë së implikuar edhe gjatë orarit të punës në veprime të mëparshme në cenim të rendit publik; iv. nuk aktivizoi asnjë nga strukturat në varësi të tij në mbrojtje të pronës publike në administrim prej tij.

15. Në vlerësimin tonë, në procedurën administrative të shkarkimit të kryetarit të bashkisë, ushtrimi i kompetencës nga autoritetet politike shtetërore karakterizohet nga një hapësirë vlerësimi diskrecionale, e cila, nisur edhe nga roli i rëndësishëm që mbart detyra e kryetarit të bashkisë, vë në baraspeshë vlerën e përfaqësimit të organeve të zgjedhura vendore me përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e tyre. Në rastin në shqyrtim, natyra e veprimeve dhe mosveprimeve të kërkuesit, mënyra se si janë zhvilluar dhe kanë precipituar ngjarjet janë të tilla që krijojnë premisa serioze për shkaktimin e një dëmi që mund të vijë nga vonesa në interesin publik. Ky i fundit, në rastin në shqyrtim, lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, garantimin e pronës publike dhe të lëvizjes së lirë të qytetarëve.

16. Edhe pse mekanizmi i ndërhyrjes për faktet e natyrës penale, sikurse arsyeton edhe shumica (*shih paragrafin 36 të vendimit*), u përket organeve të tjera (Policisë së Shtetit, prokurorisë dhe gjykatave) në bazë të rregullave të Kodit të Procedurës Penale, ky i fundit përcakton procedura dhe afate rigoroze që duhet të respektohen nga organet e lartpërmendura, të tilla që nëse do të aplikoheshin në rastin konkret, mendoj se nuk do të mund të siguronin parandalimin e rëndimit të situatës në drejtim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, si dhe të garantimit të pronës publike dhe lëvizjes së lirë të qytetarëve në kohë reale.

17. Po në këtë drejtim, pretendimi i kërkuesit se urgjenca nuk justifikohet në rastin konkret, sepse VKM-ja objekt shqyrtimi mund të pezullohet në efektet e saj nëse ushtrohet ankimi, sipas nenit 115, të Kushtetutës, në Gjykatën Kushtetuese, është i pabazuar, sepse gjendja e urgjencës në rastin konkret lidhet vetëm me elementin faktik të dëmit që mund t'i shkaktohet interesit publik në momentin kur është marrë vendimi i shkarkimit dhe është indiferent ndaj situatës juridike të perspektivës.

18. Megjithatë, për sa më lart, në kushtet kur është aplikuar përjashtimi i parashikuar nga neni 89 i KPA-së, Këshilli i Ministrave kishte detyrimin të arsyetonte në vendimin e tij për shkaqet që lidhen me urgjencën, pra me dëmin në interesin publik për shkak të vonesës, të cilat justifikonin kufizimin e së drejtës për t'u dëgjuar, si element i së drejtës për t'u mbrojtur. Për këtë arsye e gjejmë të drejtë dhe bashkohemi me qëndrimin e shumicës, e cila ka vlerësuar se vendimi i shkarkimit të Këshillit të Ministrave ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit.

Anëtarë: Altin Binaj, Fiona Papajorgji